



**KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË**  
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



**PROCESVERBAL XII/2023**

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 10 (dhjetë) të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Suharekës**

---

**Vendi:** Suharekë  
**Zyra:** Salla e Kuvendit të Komunës  
**Data:** 27.11.2023  
**Ora:** 10.00

---

**Prezentë në takim:**

Z. Shefket Kolgeci  
Z.Selman Kolgeci  
Z. Flamur Bytyçi  
Z. Urim Suka  
Z. Kushtrim Kuçi  
Znj. Elmaze Bytyqi  
Znj. Bulëza Kuçi  
Znj.Doruntina Zenelaj  
Z.Alban Berisha  
Z. Bexhet Kuçi  
Z. Reshat Selimaj  
Z. Lirim Qatani  
Z. Aziz Bytyqi  
Znj.Sanie Kuçi-  
Rexhepaj  
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina  
Z. Vullnet Luzhnica  
Z. Xhevshet Gashi  
Z.Edon Sadikaj  
Znj.Saranda  
Bajraktari  
Znj.Mimoza Bajraktari  
Znj.Festë Kabashi  
Z.Dardan Berisha  
Z.Bajram Basha  
Znj.Mevlude Kabashi  
Znj.Sheqerije Zyrapi  
Znj.Laureta Tafaj  
Z.Liridon Fandaj  
Z.Qëndrim Elshani  
Z.Herolind Limaj  
Znj.Jehona Rrafshi

**Të pranishëm të tjerë**

Kryetari i Komunës  
Media dhe qytetarë  
OSCE, LMT, KDI  
Znj.Habibe Bytyqi  
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi dhe fjalën e merr Kryetari Z.Bali Muharremaj.

**Kryetari** - e dini që kemi marrë një vendim prej gjykatës kushtetuese për faljen e tatimit në pronë për vitin 2023 dhe unë si kryetar propozoj që të jetë në rend dite pika për faljen e faturave të tatimit në pronë për vitin 2023 në vlerë deri në 100 €.

**Kryesuesi** - njëkohësisht e kemi edhe kërkesë nga grupi parlamentar i LVV-së të cilët kanë kërku të jetë në rend dite si pikë shtesë.Pasi të dyja ndërlidhen,e hedh në votim propozimin e Kryetarit dhe njëkohësisht të LVV që të futet si pikë shtesë në rend dite.

**Me 20 vota për, Miratohet pika shtesë**

**Kryesuesi** - i njofton me rendin e ditës.

### ***REND DITE***

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshimin e emërimit të shkollave sipas emrave aktual në regjistrin e pronës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-4813 të datës 27.06.2013;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;**
- 6. Falja e tatimit në pronë për vitin 2023 në vlerë prej 100 euro;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Shefket Kolgeci** - në procesverbal shkruan:mirëpo mos gadishmëria e opozitës.Duhet të shkruhet mos gadishmëria e pozitës.Ndoshta është gabim teknik.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 1 me ndryshimin që u tha.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën 2 dhe hap debatin.

**Urim Suka** - ne si LDK mendojmë që ky vendim është i vonuar për faktin që kanë kaluar afatet ligjore që kjo çështje të trajtohet me kohë prandaj i japim mbështetjen e plotë që të procedohet tutje.Mirëpo ajo që

dua të them lidhur me kompetencat që na ngarkon ligji ne si Kuvend dhe ju si Kryetar i Komunës rreth dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronave të paluajtshme, është shumë domethënëse për ju si pushtet, për ne si Kuvend por është e rëndësishme edhe për qytetarët që të jenë të informuar. Në bazë të këtij ligji Kuvendi i Komunës jep pëlqimin, formon komisionin dhe miraton vendimin final për dhënien e një prone publike në shfrytëzim dhe ne po e ushtrojmë këtë vendim siq po e bëjmë edhe sot. Më lejoni ti referohem nenit 22 të këtij ligji ku thotë:

Komuna mbikqyr realizimin e kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës sipas planit dinamik realizues. Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta 6 mujore ti paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim. Pika 3 neni 22 në rast të mos realizimit të planit dinamik të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës duke tejkalluar afatet e përcaktuara me kontratë Kryetari i Komunës merr vendim për shkëputjen e kontratës. Me këtë vendim njoftohet Kuvendi i Komunës. Pika 4 në rast të evidentimit të shkeljeve të kontratës apo shpangjes nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës nga shfrytëzuesi, Kryetari i Komunës obligohet që në çdo kohë të njoftoj Kuvendin e Komunës me shkrim së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit. Të dashur kuvendar, unë kam disa pyetje për ju e për këtë pushtet. A ka kontratatë që nuk janë implementu sipas asaj që janë miratu? Unë mendoj që po, dhe ju e dini që ka. A mund të më njoftoni se kur na ka ardhë raporti i fundit që ky pushtet ka bërë në këtë Kuvend lidhur me realizimin e kontratave? Me sa unë di, asnjëherë, dhe besoj edhe ju këtë mendim keni. A jemi njoftu me shkrim si Kuvend për shkëputjen e ndonjë kontrate nga Kryetari i Komunës? me sa e di unë, jo. Të dashur kuvendar e qytetarë, kjo është e vërteta e këtij pushteti, ky është zëri jonë opozitar dhe qëllimi i këtij zëri nuk ka asgjë personale me askënd siq disa po përpiqen ta trajtojnë por është përmbushje e mandatit ashtu siq jemi betu që në ditën e parë të këtij Kuvendi. Unë sa më parë po pres që ju ta zabtoni këtë nen e të raportoni në këtë Kuvend.

**Dardan Berisha** - duhet të sqaroj zyrtari ligjor që brenda kësaj seance a mund ta formojmë edhe komisionin për dhënie në shfrytëzim të kësaj prone që mos të vonohet si procedurë.

**Avni Bytyqi** - zakonisht ne e kemi praktiku që vendimi ta merr konfirmimin dhe pastaj të filloj procedura e formimit të komisionit. Nuk është e rregullune specifikisht me ligj mirëpo nuk përjashtohet mundësia që të formohet edhe sot komisioni. Mirëpo nëse vendimi kthehet negativ nga ministria atëherë do të shfuqizohet edhe vendimi për komisionin.

**Kryesuesi** - pasi kemi të bëjmë me një projekt-vendim për dhënien e pronës në shfrytëzim prej 1 deri 15 vite, unë kërkoj nga ju që ta përcaktojmë se sa vjet do ta japim. Unë mendoj që të jepet 15 vite nëse jeni të pajtimit edhe ju.

**Alban Berisha** - a ekziston në ekzekutiv një datë bazë ku nuk ka nevojë me prit afatin. P.sh. me i dërgu kërkesë lokalit që me liru objektin. Siq e dime na, është edhe procedura e ankesave dhe mund të shkoj me vite dhe për veq tjerash aty mund të bëhet edhe një dëm ekonomik sepse atë qera mund të ndodh që një vit se paguan askush, rrin lokali i zbrazët. Ky element negativ është edhe nëpër shkolla. Pse nuk bëhet një planifikim më i mirë të gjitha rastet, edhe të rekreatimit i njerëzve, edhe të objektet dhe të lokalet. Kush e ka ndalu që para një viti me i nis këto procedura? A e fiton pronari aktual apo dikush tjetër? Ajo rregullohet me akte tjera, rregullohet nga ana e komisionit. Nëse ka zbrazëti ligjore ndoshta është mirë me lanë pronarin aktual deri sa të shpallet fituesi tjetër por nuk kërkoj me shkel ligjin. Mundësisht të bëhen këto procedura para kohe sepse nuk e di që ka ndonjë sanksionim që nuk kemi të drejtë me bë para kohe. Edhe në arsim e kam vërejt këtë fenomen që shumë shpesh nëpër shkolla ka mungesë të stafit sepse ka dalë dikush në pension ose lindje dhe s'besoj që këto janë të pa pritshme sepse rastet e vdekjes janë diçka tjetër.

**Armend Krasniqi** - Komuna e Suharekës i ka disa lokale por zyrtarisht e ka vetëm një lokal ku e kemi regjistru me zyret e pronës dhe katastrofit. Jemi duke bërë punë të përditshme në mënyrë që ti kompletojmë të gjithë lokalet që i kemi, ti regjistrojmë në katastrof dhe të inicojmë procedura për të gjithë lokalet të cilat nuk kanë kontrata.

**Alban Berisha** - a ka raste kur ka kontrata, i ka skadu kontrata dhe ju nuk e keni marrë asnjë masë ?

**Armend Krasniqi** - i kemi, faktikisht i kanë skadu kontratat. Pronarët të cilët kanë qenë janë duke pagu rregullisht. Është çdo gjë në rregull mirëpo deri tash nuk është bërë asnjë punë me regjistrimin e lokaleve, banesave, kiosqeve. Tash kemi fillu në mënyrë intenzive. Drejtori tutje jep sqarime.

**Urim Suka** - u përmend ligji që duhet me lëshu lokalin ai. Kur dikush është uzurpator vlen ligji që ai duhet me lëshu pronën. Në rastin që ne po flasim, personi nuk është uzurpator por është personi që iu ka dhënë në mënyrë të rregullt dhe është personi më i përgjegjshëm i mundshëm ku të gjitha obligimet i ka kry. Personin në fjalë ne nuk mund ta trajtojmë si uzurpator, përkundrazi është mirë ta trajtojmë si të privilegjuar për faktin sepse i ka kry të gjitha obligimet deri tash.

**Kryesuesi** - nuk u përmend që ai është uzurpator.

**Urim Suka** - nëse ne i kërkojmë me lëshu objektin personit që është në fjalë apo kujdo tjetër që i kryen obligimet me rregull, vendimin që marrim është shumë më i rëndë edhe për Komunën edhe për personin. Është mirë që ta trajtojmë me prioritet.

**Kryesuesi** - për deri sa ka ardhë në rend dite, ne po dojmë ti bëjmë zgjidhje këtij problemi.

**Armend Krasniqi** - pronari i Pentagramit është jashtëzakonisht përgjegjës në raport me Komunën çoftë me pagesa, çoftë me çdo gjë që e ka parapa kontrata mes tij dhe Komunën mirëpo fatkeqësisht i ka skadu kontrata dhe në momentin që i skadon kontrata Komuna duhet ta iniciojë procedurën për dhënie në shfrytëzim. Njëra ndër pikat në ligj thotë që në momentin e inicimit të dhënies në shfrytëzim, prona duhet të jetë e lire. Mirëpo nëse gjejmë bashkarisht një modalitet, e sjellim në Asamble, e votojmë edhe për tre muaj që mos me liru lokalin dhe nëse nuk gjejmë alternativë duhet të jemi të përgjegjshëm ndaj ligjit.

**Urim Suka** - ligji e thotë qartë. Gati tre muaj përpara se me dal kontrata, edhe te rekrutimi dhe te këto kontratat, procedurat nisen para se me dal kontratat. E lus secilin drejtor që mos ti vonojnë këto procedura por ti ndjekin me kohë sepse pasojat po janë të mëdhaja.

**Armend Krasniqi** - mos ti politizojmë gjërat. Këto problematika që po i cekim nuk janë të sodit por janë që 23 vite. Sot ia kemi nis me u marrë me diçka që nuk jemi marrë qe 23 vite as me detajin më të vogël. Është e vërtetë që procedurat për inicim fillojnë 3 muaj përpara por kemi pas edhe probleme tjera në lidhje me atë lokal.

**Shefket Kolgeci** - e përkrahi drejtorin me qëndrimet e tij që i tha. Gjejeni një modalitet dhe ne sot do ta votojmë këtë projekt-vendim. Qëllimi është që të jetë mirë edhe për Komunën dhe për investitorin.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2 që lokali të jepet në shfrytëzim për 15 vite.

## Unanimisht Miratohet

### **Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshimin e emërimit të shkollave sipas emrave aktual në regjistrin e pronës;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën 3 dhe hap debatin.

**Alban Berisha** - kisha pas dëshirë që në rastet e vendimeve të tilla, pikërisht me vendimet e sotme, Drejtori i Pronës apo i Arsimit, para se me marrë fjalën ne për debat, me dal dhe me dhënë arsyetimet se pse ka ardhë dhe si ai vendim. Ne e kemi një vendim në email dhe dime me e pa arsyetimin aty por për hirë të korrektësisë është mirë të jepen arsyetimet. Mund të ndodh që komplet dy javë unë kam mendu me kundërshtu por mund të ndodh që nuk e kundërshtoj sepse ma ka dhënë një argument shumë të mirë që është një vendim i mirë. Duhet të hiqet logjika me paraqit një vendim edhe ne me menu çka me fol ku secili drejtor është kompetent për punën e vet. Nëse i keni pru pikat me ec, unë e di që i keni numrat por ta bëjmë një debat të mirëfilltë. Unë arsyetim s'po ngoj asnjëherë në asnjë akt këtu, vetëm po pres kush po e qon dorën me fol rreth atij vendimi. Duhet me na argumentu edhe pse jemi opozitë sepse nuk jemi kanë gjithmonë kundra por edhe kemi votu pro. Në moment kur u kanë argumenti i qartë dhe ne kemi mendu që është për të mirën e qytetarit, ne e kemi votu. Ka raste që e kemi kundërshtu por kjo është demokracia.

**Armend Krasniqi** - çështja e ndërrimit të emrave të shkollës në Komunën e Suharekës është një problematikë e madhe sepse kemi emra të cilat kanë mbet prej sistemit të ish Jugosllavisë dhe akoma po

ekzistojnë në fletat poseduese të qertifikatave të pronave të tyre.Ne po dojmë ti ndërrojmë ato emra dhe ti kthejmë në emra shqip.Është një vendim që patjetër duhet me u mbështet nga secili asambleist.

**Kryetari** - rast konkret e kemi edhe shkollën fillore “Migjeni” në Gjinoc. Me një kohë në Gjinoc ka qenë Tërrnja, Leshani, Greikoci, Gelanca. Ende figuron pronae shkollës në Greikoc dhe atë duhet me ndryshu sepse ajo shkollë ka emër dhe mbiemër.Nesër me dasht me punu diçka në Greikoc,aty po figuron që shkolla fillore “Migjeni” në Gjinoc.

**Urim Suka** - e përgëzoj drejtorin e Katastrës për aktivitetin që e ka ndërmarrë që kjo çështje të përmbillet por përtej kësaj ne e kemi një shqetësim që Albani e ngriti dhe as nuk u plotësu në mënyrën e duhur qysh Albani e kërkoi.Shqetësimi jonë është që ky vendim që ju e keni sjell,a është i përgaditur mirë ligjërisht që mos me pas kthime qysh po na kthehen vendimet në vazhdimsi.Për mu është ende e paqartë dhe çfarë vendimin po marrim.Ndoshta na s’ mujna veq me i ndryshu këto,ne mujna me dhënë pëlqimin për me ndodh kjo e tani procedurat duhet me i ndjek tjetër kush.Dua ta jap mendimin tim.Emrat e shkollave emnohen me propozim të këshillave të shkollave pastaj shkon te DKA-ja dhe shkon në ministri dhe emnohet emri i shkollës.Pra shkollat janë emërtu me emra të rinjë mirëpo qertifikata e pronësisë ka mbet me emrin e vjetër sepse nuk i ka ndjek askush ato procedura.Nëse unë po e kuptoj drejtë,ky vendim që ne po e marrim sot ka të bëjë me dhënien e pëlqimit tonë që Drejtoria e Katastrës me i ndjek këto procedura që emrat e shkollës ekzistues që janë,me kalu edhe si pronarë në parcelë,me figure i njejt emër.Duke e llogaritë që ky vendim nuk është shumë i qartë,dua të kërkoj një sqarim edhe prej katastrës.Cila është baza ligjore që ne me marrë këtë vendim?A është mirë i përgaditur dhe a ka mundësi mos me u kthy ky vendim?Te lista që na është dhënë,gjendja faktike në katastër,p.sh. shkolla “Ramë Bllaca” figuron emri “Emin Duraku” në katastër.Emërtimi ekzistues i shkollës thotë “Emin Duraku”.Emërtimi ekzistues i shkollës më nuk është Emin Duraku por është “Ram Bllaca”.Mendoj që kjo tabelë që neve na ka ardhë ndoshta nuk është e përgaditur mirë teknikisht.Vullneti këtu ka qenë i mirë dhe ne si LDK e mbështesim.

**Armend Krasniqi** - iniciativa për ndërrimin e emrave të shkollave ka ndodh ku kemi pas probleme me disa tendera.P.sh. nëse e kemi shpall një tender me emrin Lenin dhe kemi dasht me ndërtu një shkollë,ku e kemi nxjerr qertifikatën e pronës, aty ka shënu parcela Lenin ndërsa shkolla Edit Durham.Në kuadër të këyre problemeve kemi marrë iniciativa.Ka shku kjo çështje në ministri në 2010-të dhe kemi vendime të ministrisë ku ka marrë iniciativë për ndryshimin e këtyre problematikave që kanë qenë në gjithë Kosovën mirëpo në rastin e Suharekës kur e kanë sjell me ekzekutu në 2010,vendimet të cilat i kanë nxjerr nuk kanë qenë të ekzekutueshme në katastër për shkak të disa specifikave që i kërkon katastra.Nuk ka pas numër parcela dhe nuk ka pas sipërfaqe adekuate të cekura se si me ndërru emrin e asaj prone.Agjensioni kadastral na ka rekomandu që kjo problematikë zgjidhet vetëm me Asamble.A e kthejnë apo nuk e kthejnë ministria,kjo është çështje tjetër që duhet me marrë edhe juristat pak ma shumë dhe çdo kush që merret me përgaditjen për me na garantu a e kthejnë ministria apo nuk e kthejnë por ma merr mendja që nuk kanë me kthy.

**Kryesuesi** - përmende emrat ekzistues.Kjo ka të bëj me emrat e pronave që i kanë tash.Është e vërtetë që emri ekzistues i pronës ku për momentin e ka Emin Duraku shkolla e Bllacës.

**Urim Suka** - te emri ekzistues i shkollave shkruan:shkolla Emin Duraku.Shkolla nuk e ka më emrin Emin Duraku dhe ndoshta është gabim teknik.Për mua është i paqartë neni 1.Dua ta di,a jam duke e dhënë pëlqimin që Drejtoria e Katastrës me i kry këto procedura?A jam drejtpërdrejtë duke e ndërru emrin dhe a kam unë kompetencë me ndërru emrin?Jemi duke e përkrah si peojekt-vendim,por veq dua ta di se a është i përgaditur mirë.Kërkoj interpretim edhe nga drejtorit dhe nga zyrtari ligjor.

**Remzi Bajselmani** - kjo kërkesë është eksluzive e imja dhe është qe tri vite.Tre vite kam punu për me u bë ky ndryshim.Ka pas vështirësi për me gjet nene e ligje.Sot merr vendim Asambleja që të autorizohet drejtoria e katastrës për ti vendos emrat e pronave sipas emrave të shkollave që janë legjitime nga ministria e Arsimit.Ram Bllaca e ka pronari Emin Duraku etj.

**Armend Krasniqi** - nuk ka qenë e Remziut.Ka qenë e çdo drejtori që ka ardhë dhe e ka pas andërr me ndryshu këtë.Janë marrë me këtë problematikë mirëpo ndryshimi ka ndodh eksluzivisht nga zyrtarët e pronës.Meritë të madhe ka Emrush Bytyqi.

**Shefket Kolgeci** - ne mendojmë që nuk e keni formulë mirë nën 1. Neni 1 thotë: me këtë vendim bëhet ndryshimi i emërimit të shkollave sipas emrave aktual. Duhet të jetë: me këtë vendim bëhet ndryshimi i emërimit të pronave të shkollave me emrat aktual që i kanë. Këto nuk po i analizoni mirë, nuk po i shtjelloni mirë por vetëm, shkruaje aty se e votojmë në Asamble.

**Urim Suka** - drejtori e sqaroi shumë mirë por ajo nuk po reflekton te neni 1.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 3 me propozimin e Shefket Kolgeci.

### Unanimisht Miratohet

#### **Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-4813 të datës 27.06.2013;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Shefket Kolgeci** - kërkoj sqarime të shkurta dhe të qarta. Sa m<sup>2</sup> jep Kuvendi Komunal dhe sa merr?

**Armend Krasniqi** - ne po ia japim 2 ari e 86 m<sup>2</sup> dhe ia kemi marrë 2 ari e 86 m<sup>2</sup>.

**Shefket Kolgeci** - me rëndësi me rregull infrastrukturën rrugore dhe atij qytetari mos me i shkakto dem. Jam për favore reciproke dhe jo të njëanshme.

**Selman Kolgeci** - Kryetar, është dashtë që disa herë me u zhvillu procedura paraprakisht, me u lidh kontrata disa herë, me u shpenzu mjete dhe kjo rrugë mos m'u bë asnjëherë e tash me ju ra ndër mend që duhet me u inicue një procedurë për këmbim të pronave për atë rrugë. Nuk e kam të qartë se si do të veprohet me parcelat 2843 dhe parcelat 2843-3. Kryetar, a po keni telashe me prona kur po shtroni oborre private dhe rrugë private? A po keni qesi telashe sepse edhe këtu bëhet fjalë për një pronë private që është pengu. A keni bërë raport të vlerësimit nga një vlerësues i licencuar për të ditur vlerat e pronës së këmbimit që po bëhen? Si është menduar që një rrugë e cila prek parcelat si pjesë të këmbit siq janë: parcelat 3011-5, 3012-5, 2845-3 në zonën kadastrale në Mushtisht të cilat pretendohet të lidhin rrugën "Ali Bytyqi" me atë "Selman Tahiri" me gjerësi rreth 1.9 m që ti shërbej banorëve në atë pjesë për kalimin e mjeteve motorike? A mendoni se kjo rrugë i plotëson kriteret teknike për lëvizjen e automjeteve? Si e keni menduar zgjidhjen e kontestit të rrugës "Ali Bytyqi" që lidhet me rrugën "Bafti Shala dhe Sadri Azemi" dhe që kalon nëpër parcelat 2843-1 pjesërisht dhe 2843-3, prona këto të cilat janë në emër të personave privat apo thjesht do ta mbyllni këtë dalje dhe do të kalohet në rrugën me gjerësi rreth 1.9 m. A mund të na tregoni se cili është interesi i përgjithshëm për këmbimin e këtyre pronave sepse në këtë rast Komuna po jep pronë shumë të vlefshme për të nxjerrur një rrugë me gjerësi 1.9m?

**Armend Krasniqi** - kjo tematikë e këtij këmbimi ka qenë në 2013-tën mirëpo për shkak të disa ndarjeve të parcelave të cilat kanë ndodh aty, nuk u ekzekutu kurrë ai vendim që u votu në Asamble 2013 për shkak të ndryshimit të numrave. Personit ia kemi shtrur rrugën për interesa të fshatit dhe është dashtë me ia këmbu pronën. Ai çdo ditë ka ardhë në zyre dhe ka pyet se pse nuk po ekzekutohet vendimi që është. Kur e kanë nda parcelën, ka ndryshu numri dhe kur e ka sjell me ekzekutu në katastrofë nuk është ekzekutu kurrë ai vendim. Kemi dalë në tren, i kemi rirregullu numrat dhe e kemi sjell në katastrofë me numrat aktual të cilat i kemi sjell në Asamble. Sa i përket se a kemi analiza të shpronësimeve, faktikisht kemi shumë lloje të analizave të cilat i kemi bërë lidhur me shpronësimin. Ka qindra problematika të shpronësimit që nuk kanë fillu as 2015, as 2016, as 2017 por kanë fillu që nga vitet e '60-ta, '70, '90 e faktikisht këtu duhet një altileri e jashtëzakonshme e juristave për me i rregullu këto gjana dhe mbi të gjitha duhet me qenë interes i shtetit me u marrë intezivisht me këtë punë.

**Selman Kolgeci** - potencut që keni telashe me shpronësimet por me qëllim që mos me pas probleme pikërisht. Pikërisht për këtë thashë. A keni marrë raport të vlerësimit nga vlerësuesi i licencuar që nuk duhet të jetë punëtor i Komunës. Keni marrë pjesë të pronës për me kriju një rrugë 1.9 m të gjerë. A e keni idenë sa është 1.9 m e gjerë? A jemi duke e mbyll rrugën "Ali Bytyqi"? Nëse jo, pse nuk janë trajtu edhe prona 2843-3 dhe prona 2843-1 pjesërisht?

**Kryetari** - nëse kalon kjo pikë, kjo ka me shku edhe ma tutje te komisioni dhe me shiku ligjshmërinë se a janë në rregull apo jo. E cekim edhe drejtori, është një problem prej vitit 2013 për shkak se kanë ndryshu numrat. Ti që po pyet, ai është një problem tjetër, që ka pas problem mes dy familjeve Durmishi. Ajo rrugë

me vendim të kryesisë është bartë në 2019-2020 dhe ai problem është kry. Ky është një problem që e bën kompensimin e njejta familje Durmishi me pronën komunale. Kryetari tuje jep sqarime.

**Selman Kolgeci** - a po dojmë me zgjidh çështjen e rrugës "Ali Bytyqi"? Hajde ta zgjidhim në tërësi. Kryetari potencoi që jemi duke pagu prap për rrugën "Brigada 123", rrugën e Sopijës dhe rrugën e Buzhalës. Mirë. Për mos me ndodh kjo, hajde sot e rregullojmë këtë. Nuk jam kundër për me hap rrugë por jemi duke dhënë pronë për me qel rrugën 1.9m Kryetar.

**Kryetari** - ne do ta bëjmë atë rrugë sa kemi mundësi me bo për arsye se me hy me shpronësu, aty duhet me i rrënu 10 shtëpi. Ti e din në anën e dhjathtë si janë shtëpitë të rregullune dhe nuk ka kush që e paguan atë rrugë. Ne rrugën do t' mundohemi me bo dhe së paku ndoshta e bëjmë një mur mbrojtës rreth lumit dhe së paku me bo një rrugë 4 m dhe në të ardhmen ndoshta bëhet një drejtimëshe, si lloj unaze sepse nuk kemi zgjidhje tjetër.

**Armend Krasniqi** - drejtori dhe një herë jep sqarime dhe thotë që është vendim i njejtë i 2013-tës dhe tash i kemi rregullu numrat ekzistues që kanë qenë dhe atë vendimin e njejtë të 2013-tës e kemi sjell në Asamble edhe një herë. Prap ka me kalu ligjshmëria edhe në ministri.

**Kryesuesi** - në 2013 kur është bë këmbimi i pronës, prona private ka qenë si pronë në tërësi me një numër. Tash janë nda vëllezërit dhe janë kriju numra të rinjë dhe po kërkojnë me u regjistru numrat e rinjë në emër të vëllezërve që është nda parcella.

**Selman Kolgeci** - atë po e kuptoj por atë që s'pe kuptoj dhe që po e bëj pyetje që disa herë dhe nuk po marr përgjigje është se, te qëllimi kur e keni sjell raportin është hapja e rrugës "Ali Bytyqi e paraparë në kuadër të projekteve të investimeve kapitale. A kemi me hap këtë rrugë? Nëse po, pse nuk janë trajtu edhe dy pronat tjera? Çka nëse sot na e kalojmë këtë, ku kjo kalon në pronën e pronarëve privat ndërsa pjesa tjetër kalon në pjesën e Komunës. Te këto dy parcella na del prap problem.

**Kryetari** - nuk ka të bëj kjo parcelë me hapjen e rrugës "V. Ali Bytyqi".

**Selman Kolgeci** - te qëllimi ju këto na i keni dërgu.

**Armend Krasniqi** - nuk po të kuptoj Selman. Ti po thua që ne pasi ta bëjmë këmbimin, pronari e mbyll komplet rrugën.

**Selman Kolgeci** - jo, nuk e mbyll komplet rrugën. Kemi probleme tjera në këtë rrugë. Ju te qëllimi u dasht me shënu që po don me u rregullu vendimi i viti 2013.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

**28 për ,1 apstem  
Miratohet pika 4.**

#### **Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe kërkon nga subjektet politike ti japin emrat e anëtarëve të komisionit.

**Aziz Bytyqi** - ne kemi si propozim Mimoza Bajraktarin.

**Urim Suka** - ne si LDK nuk kemi kandidat për këtë komision për shkak të neglizhencave të mëdhaja që janë bërë këtu.

**Dardan Berisha** - ne si subjekt politik nuk kemi kandidat për këtë komision.

**Qëndrim Elshani** - ne si LVV nuk kemi propozim për këtë komision.

**Jehona Rrafshi** - ne si Nisma Social Demokrate nuk kemi kandidat për këtë komision.

**Herolind Limaj** - as ne nuk do të jemi pjesëmarrës për këtë komision.

**Kryesuesi** - atëherë pasi nuk ka prej subjekteve politike, unë kërkoj ta tërheqim prej pikes së rendit të ditës këtë projekt-vendim.

**Kryetari** - janë grupet parlamentare. Me ju fut në komisione, s'po doni. Mos me ju fut në komisione, pse s'po na futni në komisione. Nëse nuk doni, ne e tërheqim vendimin.

**Laureta Tafaj** - Kryetar, pothuaj 90% të komisioneve i ke vetëm me pozitën dhe me kualicionin. E çka u bë që këtë komision s'po munesh me bo?

**Kryetari** - disa komisione i kemi sjell në bazë të ligjeve që janë në fuqi, në bazë të rregulloreve.

**Alban Berisha** - Kryetar, shumë në rregull është kur e bën një kërkesë me shkrim opozita dhe real ti e ofron, që dyshoj që mund të ndodh kjo. Edhe mos me hy në komision, munesh me thane: po vet kërku, vet nuk dashtet dhe e lëmë këtë punë. Sinqerisht e them, janë lojna të dyfishta. Kur të intereson një proces me qu përpara, përkundrazi kur ne insistojmë ne me hy në atë komision që mendojmë që duhet me hy, ti e rregullon punën me këto minipauzat e Kryesuesit shumë shpejtë që ne mos me qenë aty. Unë kërkova një pauzë që ta bëjmë një konsult dhe ju thatë shumë shpejt dojmë me kry. Është përgjegjësi e ekzekutivit. Dëshëm apo nuk dëshëm, është detyrë personalisht e jotja si Kryetar, si kryesues i ekzekutivit bashkë me Kryesuesin e Kuvendit dhe me marrë këtë punë dhe me kry si është më së miri. Nëse ne nuk marrim pjesë, ja ku i ke të partisë tënde dhe të koalicionit. Ne nuk thojmë kurgja, vetëm kryje.

**Kryetari** - më duket që jemi duke e zbatu rregulloren e Asamblesë Komunale. Ne ju ftuam, ju s'po doni me hy. Nuk bën vetëm një parti me marrë vendime. Ne jemi sistem shumëpartiak. Është demokraci.

**Kryesuesi** - formimin e komisionit e ka Kuvendi për obligim dhe çdo herë ka qenë kështu.

**Alban Berisha** - unë e respektoj mendimin tënd por tash s'po di cilit mendim tëndit me i besu.

**Kryetari** - është zyrtari ligjor.

**Alban Berisha** - unë po të pyes ty.

**Kryetari** - për atë arsye është ulë me mua dhe unë duhet me pyet këtë.

**Alban Berisha** - kur po të konvenon ti s'po e pyet zyrtarin ligjor. Pse se ngove zyrtarin ligjor për themelimin e tatrës? Kryetar ta respektoj mendimin por unifikoj mendimin. Këtë punë s'duhet me lënë kështu. Mund ti thuash Azizit, ti prozon edhe dy. Nuk është shkelje ligjore.

**Kryesuesi** - Azizi e dha një emër.

**Alban Berisha** - mbetet që ekzekutivi nuk është i interesuar me qu këtë çështje përpara.

**Dardan Berisha** - komisioni ka qenë i formuar dhe se sa ka qenë funksional, ne nuk kemi kurrfarë raporti se deri ku ka shku procesi i funksionimit të atij komisioni. Në seancën e kaluar kanë dhënë dorëheqje të tre. Në këtë rast të njejtën pyetje e bëri Albani. Kur formohen komisionet atëhoqe, propozohet. Mund të propozohen tre dhe nëse lejohen prej Kuvendit, le ti marrin votat dhe kalojnë prej grupit tuaj.

**Urim Suka** - e përkrahi atë që tha Albani por dashta me kthi memorien kur i kemi formu komisionet në fillim atëherë, me ato debatet që i kemi pas. Ju atëherë i formojshit komisionet. Ne kishim propozime por ju nuk i përkrahnit propozimet. Kjo është në vullnetin tuaj. Doni me shty përpara si pushte, e keni mundësinë sepse keni vepru më herët me ato komisionet që ju kemi kritikë. Për shkak që ju këtë lëndë nuk e keni pas kurrë prioritet për me shty përpara dhe për shkak të krejt kësaj neglizhence, ne nuk dojmë me u bë pjesë e këtij komisioni përndryshe ne do të jemi pjesë e të gjitha komisioneve.

**Aziz Bytyqi** - çështja e mungesës së vullnetit, nuk është konstatim i saktë sepse ne nuk po ju prejashtojmë juve me qenë anëtar të komisionit. Mund të jetë ligjore por nuk ka logjikë prej një partie politike me qenë tre përfaqësues prej Asamblesë dhe dy prej ekzekutivit. Është fakt ajo që një herë ka ndodh diçka kur është bërë komisioni për prona, kur nuk ka pas përfaqësues nga opozita. Të gjitha komisionet sot janë të bërëra nga të gjitha partitë politike. Unë në fakt i kam dy propozime por s'po du me bo munizëm. Hyni ju me një dhe unë e jap propozimin e dytë.

**Urim Suka** - mua po më vje keq për mënyrën se si po më portretizoni të gjithë. Sot ne i votuam gati të gjitha pikat. Azizi mi ndryshoi krejt çka thashë. Unë nuk thashë që ju nuk keni vullnet mos me na lane në asnjë komision. Unë thashë për komisionin konkret. Ju tash s'keni vullnet me shty këtë lëndë përpara. Ky e kapi këtë fjalë dhe e qoj ka dashti vet. Për këtë vendim unë jam tu thane që ju s'po keni vullnet me shty përpara. Për atëherë, atë që e përmendi edhe ky, ne kemi pas kandidat por ju s'na keni lënë. Komisioni nuk formohet veq me një parti, kandidati dytë duhet mu kanë prej subjekteve të ndryshme politike. Ju atëherë e kishit një kandidat të PDK-së. Ju jeni në koalicion dhe edhe tash mundeni me pas një kandidat të PDK.

**Aziz Bytyqi** - për që kemi vullnet jepe ti një propozim dhe unë të dytin e kam gati.

**Armend Krasniqi** - në komisionin aktual i cili ka dhënë dorëheqje e kemi kry 90 % të punës. Kjo është në interes të përgjithshëm dhe është një çështje jetike e qytetarëve të Suharekës me zgjidh këtë kompleksitet që ka ndodh disa vite me radhë. Sot po i propozohet AAK-së dhe AAK është mire me gjet një ekspert të mire që e shtyn këtë çështje përpara dhe LDK-së po i propozohet një mundësi për me i



ndihmu qytetarëve të Suharekës. Te PDK fatkeqësisht nuk kemi zyrtar kompetent për këtë. E keni propozu një anëtar në t'kalumen dhe kurrë s'ka marrë pjesë.

**Shefket Kolgeci** - e vërtetë. Një anëtar nuk ka marrë pjesë. I ke pas 4 anëtar tjerë dhe një anëtar po ke dhe po s'ke, ish kry procedura. Faji nuk është te anëtari por te dikush tjetër. Kur më ka ardhë materiali i parë, e kam lexu dhe e kam pa që nuk është në rregull dhe nuk kam ardhë në asnjë mbledhje. A ju kujtohet komisioni kur e keni formu në fillim të këtij mandati dhe a ju kutohet se çka ju kam thënë? I kam thënë Kryetrit: Kryetar, kjo është autokraci jo demokraci sepse po na mbi voton me vota me kualicionin që e ke. Atëherë nuk ju duheshim ne juve. Pse tash po ju duhemi? I kam thënë Kryetrit edhe privat: mu po më befason, që 23 vite jam në Asamble dhe nuk ka pas asnjë komision pa opozitën.

**Armend Krasniqi** - herën e parë kur u formu komisioni i tokave, u formu vetëm prej pozitës mirëpo herën e dytë kur e kemi dhënë një pronë ka qenë Kushtrimi në komision dhe ai është në komision. Kur ka ardhë komisioni i Zonës Industriale që çdo here kishim pyetje, se jo ka parregullsi të mëdhaja dhe se Z I është katastrof, ne kemi kërku të propozoni një anëtar tuajin dhe as LDK-ja, as LVV-ja prapë nuk keni dasht.

**Alban Berisha** - herën e parë nuk ka pas asnjë anëtar prej opozitës në komision dhe herën e dytë po. Është e vërtetë. Kur është votu herën e parë ka qenë sipas ligjit të vjetër që komisioni u formu për mandatin 4 vjeçar dhe kur e keni bo ju, vetëm pozita, e keni bo me mandat 4 vjeçar. Pasi ka hy në fuqi një akt normativ tjetër, u bë që për secilën pronë me u bë komision i veçantë. Dhe kur kanë nis të bëhen komisionet për secilën pronë, ju keni nis me na ftu edhe neve.

**Armend Krasniqi** - asnjë normativ nuk ka ndryshu dhe nëse e konstatoj ashtu, e ke gabim.

**Alban Berisha** - në pikën e parë Urimi e cekti nenin 22 për pronën se kush është përgjegjës. Aty shumë mirë ceket. Vetëm lexoje nenin 22.

**Reshat Selimaj** - unë dua të ndërlihem me Urimin dhe Dr. Shefketin për shkak se është e padrejtë me thane këtu se nuk kemi përfaqësime. 95 % keni përfaqësime nëpër komisione. P.sh. kur e kemi formu komisionin e bursave, mua më duket e padrejtë që Asamblea me dhënë dhe Asamblea me shqyrtu ankesën. Aty ku përfitoni pak po ngani krejt. Bjerne një emër dhe unë po propozohem i dyti. Unë po garantoj që në qoftëse gjejmë shkelje ligjore, prapë e sjellim në Asamble dhe japim dorëheqje por jo me sabotu.

**Urim Suka** - unë nuk e di se pse po i keqinterpretimi fjalët që i japim. Unë fola për çështjen konkrete. Nuk thashë që s'jemi të përfaqësuar dhe nuk thashë që s'kemi me qenë. Në të gjitha komisionet ne kemi me qenë dhe kemi me i marrë përgjegjësitë që na takojnë. Te pjesa që përmendi Drejtori për Z. Industriale, e tha edhe Albani. Unë e lexova nenin por Kryetari nuk më dha përgjigje. Kurrë s'na ka sjell raport për kontrata që s'po zbatohen. Kurrë s'na ka sjell raport për një kontratë që e ka shfuqizu. E ka detyrim ligjor që çdo 6 muaj me i raportu këtij Kuvendi.

**Laureta Tafaj** - Kryesues, nëse keni vullnet me u formu ky komision, kërkojmë përsëri 5 min. pauzë sepse opozita do jna me u konsultu mes veti. Reshat, 1 vit kam punu në këtë komision dhe e kam ditë që s'ka pagesë por kam punu me shumë dëshirë. Mos thuaj tjetër herë ashtu.

**Reshat Selimaj** - unë të ftoj. Nëse ke qenë, hajde prap dhe në qoftëse ka shkelje, ne japim dorëheqje prapë por jo me sabotu.

**Kryesuesi** - sipas kërkesës së Lauretës, jap 5 minuta pauzë.

**Kryesuesi** - pas pauzës Kryesuesi kërkon propozimet.

**Laureta Tafaj** - pas konsultimit me opozitën, ne kërkojmë prej jush që shtyhet për një seancë tjetër dhe ti japim propozimet tona.

**Kryesuesi** - e hedh në votim me tërheq këtë pikë për seancën tjetër.

**20 për, 4 apstenime**  
**Tërhiqet pika 5**

**Pika 6.**

**Kryesuesi** - ia jep fjalën Drejtorit të Financave për pikën shtesë.

**Labinot Halitjaha** - jep sqarime sa i përket pikës shtesë dhe thotë që gjykata kushtetuese ka vendosë më herët me pezullimin për pjesën e 100 euroshit që nuk ia ka leju Komunave për me zbrit këtë tatim ndërsa tash me vendimin e ri ia ka lënë në diskrecion Komunave të vendosin se a dojmë me fal vlerën 100 euro për çdo tatim pagues në nivel komunal.Çdo tatim paguesi do ti falet borgji deri në vlerën 100 € të vitit 2023.Drejtori tutje jep sqarime.

**Qëndrim Elshani** - është hera e tretë që gr. i LVV po tenton me fut në rend dite pikën për faljen e faturës së tatimit në pronë në vlerën deri në 100 € për secilin tatim pagues në Komunën e Suharekës.Herën e parë kemi kërku nënshkrimet për seancë të jashtëzakonshme,ku nuk kemi gjet përkrahjen as të pozitës dhe as të opozitës.Mbledhjen e radhës kemi tentu si pikë në rend dite,të paktën për diskutim ku edhe aty kemi has në të njëjtën situatë.Pas publikimit të aktgjykimit të gjykatës kushtetuese të RKS,MFPT i ka njoftu Komunat e RKS për pëmbajtjen e aktgjykimit si dhe për afatin e përcaktuar nga gjykata për zbatimin e dispozitës ligjore për faljen e tatimit në pronë për vitin 2023 në vlerën prej 100€.Andaj sot pas publikimit të këtij aktgjykimi më në fund arritëm ta fusim si pikë në rend dite ku edhe një here ju bëjmë thirrje që të kalohet kjo pikë pasi që është në të mirën e qytetarëve.Duke marrë parasysh njoftimin se Komunat deri më datë 8 dhjetor 2023 mund të vendosim rreth faljes së tatimit në pronë,unë ju bëj thirrje që duhet të votohet patjetër sot ose vetëm ta thirrjmë një seancë të jashtëzakonshme.

**Kryesuesi** - ne e kemi fut në diskutim dhe ne sot e përfundojmë.Nuk kemi nevojë me thirrë seancë të jashtëzakonshme sepse jemi duke diskutu dhe a kalon apo nuk kalon është në diskurcion të Kuvendit.

**Qëndrim Elshani** - duke marrë parasysh që ne deri me 8 duhet me marrë vendimin,po i ftoj që të votohet sot dhe mos ta thirrjmë edhe një herë një seancë të jashtëzakonshme.

**Urim Suka** - zakonisht neve po na thuhet që po bëjmë politikë dhe me vendimin e tatimit në prone filluat ju me bë politikë.Ajo që ke interesant,fakti që ke, se kur ka ardhë një kërkesë me shkrim prej LVV,u qu kryetari me zan renin pak përpara,se du me fal tatimin në pronë.Kryetari ka mujt me pru letrën para LVV-së.Në anën tjetër,Drejtori tha:unë ju kisha thanë mos me votu se na dëmtoni buxhetin.Edhe ai bëri politikën e vet e që nuk i bje mirë partisë së vet.Kur e mor Qëndrimi fjalën,edhe ai bëri politikë se tha nuk e ka përkrah LDK-ja.Krejt partitë po e sulmoni LDK-në se po bëjmë politikë dhe në anën tjetër ju po bëni politikë.Në faktin kur ne nuk e kemi përkrah herën e parë qëndrimin e LVV,ka qenë se kemi pas dyshime ligjore për një vendim se a

kemi të drejtë me marrë apo jo si Asamble.Ditën kur jemi sot ne nuk e kemi më këtë shqetësim ligjor sepse e ka dhënë verdiktin gjykata kushtetuese dhe me këtë rast ne i japim mbështetje të plotë qëndrimit të LVV-së për me fal tatimin.

**Qëndrim Elshani** - i nderuar Urim,më shumë se ti politikë nuk bën kërkush në këtë Kuvend Komunal.Cila fjalë,fajali,shkronjë nuk qëndron?

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 6.

**17 për,8 kundër,4 apstenime**  
**Miratohet pika 6**

### **Pika 7.Pyetje dhe përgjigje;**

**Elmaze Bytyqi** - kërkesë për Drejtorinë e Shëndetësisë edhe pse Drejtoresha nuk është e parnishme.Në planifikimin e aktiviteteve të prokurimit për vitit 2024,të planifikoj edhe paisje me aparat mjeksor të defibrilatorit,paisje kjo që i referohet një instrumenti të veçantë,i aftë për të zbuluar ndryshimet për ritmin kardiak dhe për të dhënë një goditje elektrike në zemër kur është e nevojshme.Këto paisje mund të vendosen në 2-3 pozicione të frekuentuara në rrugët dhe sheshet e qytetit tonë dhe në rast të emergjencave mund të përdoren për personat që kanë nevojë.Këto paisje të jashtme të automatizuar në ndihmë të qytetarëve ose ndryshe njihen si projekt “Zemër e mbrojtur në qytet në rast të sulmeve cardiake”.Vlera e përafërt e kësaj paisje vijon prej 2000 deri në 2500€.Ne kërkojmë nga Drejtoria e Shëndetësisë që ta merr parasysh kërkesën e parashtruar.

**Remzi Bajselmani** - ne i kemi vendos këto në tri shkolla të mesme. I kemi pas donacion prej Kforit Italian dhe qytetrët janë të njoftuar me këto lloj aparatesh.

**Dardan Berisha** - drejtuar Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kur e pata bë një pyetje në qershor rreth përfundimit të projektit të fushave sportive në Gjinoc, përgjigja ka qenë epike: s'po ka mundësi me u përfundu sepse po ka reshje atmosferike. Realisht vonesë në mos kryerjen e punës ka qenë devijimi i projektit. Pra, operatori ka kërku pagesë shtesë për ta përfundu këtë projekt. Projekti ka fillu me 28 shtator 2022 dhe ka përfundu në nëntor të 2023-tës, nëse ka përfundu. Drejtoreshë merre si sugjerim. Si i ka kërku ai mjetet sepse projekti është deviju. Mos e prano pa e përfundu në bazë të standarteve atë projekt sepse ai teren sportiv është në gjendje katastrofale. Mjetet shtesë, diku afër 6000€ për përfundimin e këtij projekti, nga cila vijë buxhetore janë marrë? Shumë shkolla e kanë ndërpre procesin mësimor për shkak të temperaturave të ulta dhe kjo si rrjedhojë e keqmenaxhimit dhe funksionimit të organeve përgjegjëse. Me 15 nëntor është data e përcaktuar si fillim i funksionimit dhe ndezjes së ngrohjeve por kjo nuk ka ndodh sepse s'kanë pas se si me u ngroh. Pas fazës së tenderimit, ankesa e njërit nga operatorët ka shkuar në OSHP duke aluduar se operatori fitues i furnizimit të shkollave me lëndë djegëse është dikun 13.950 € më i shtrenjtë. Me 22 nëntor organi shqyrtues i prokurimit ka hudhë poshtë edhe këtë kërkesë të njerit nga operatorët. Në gusht është publiku dhe ka dalë faza e aplikimit si tender për furnizimin e shkollave me lëndë djegëse. Për mua është i vonuar muaji gusht dhe kjo tregon keqmenaxhimin nga Drejtori i Arsimit. A keni marrë pjesë si drejtor i arsimit ose si komision në ndonjë shkollë në procesin e pranimit të lëndëve djegëse? Mbi çfarë kontrate i ka mbulu operatori disa shkolla para dates 22 nëntor, ende pa u kry lënda në OSHP?

**Lorika Gashi** - Dardan, kam dal por do të dal prap ka Gjinoci dhe e shohim. Nuk janë 6000€ por 4751€. Ato i kam marrë prej projekteve-fushave sportive Bllacë-Studenqan, teprica e tyre ku kam bë kërkesë te ZKA dhe me aprovimin e ZKA-së iu ka bë pagesa, e pjesës së mbetur të cilat nuk i ka marrë vitin e kaluar pa e kry punën. Mundesh me bë qasje dhe me pa edhe ditarin e punës. Jo ai por asnjë projekt tjetër, nuk e merr asnjë pagesë pa e kry punën.

**Dardan Berisha** - nuk ka rëndësi sa. Unë thashë 6000 ka i keni marrë dhe pyetja ishte konkrete. Qysh i ka lyp ai edhe 6000 për me përfundu projektin, edhe ti mos ja prano.

**Lorika Gashi** - me vetëdije timen asnjë cent.

**Remzi Bajselmani** - procedurat për furnizimin me lëndë djegëse i inicon DKA, të cilin e ka bë në qershor. Lënda ka qenë mjaft e madhe, për tre vjet kornizë dhe ka dasht procedura dhe afër 45 ditë nuk është hap. Me 8 korrik kanë fillu procedurat dhe sa ka zgjat procesi është pjesë e prokurimit. Pas shqyrtimit të ofertuesve lënda ka shku në OSHP gjë që jemi shqetësua. Fatmirësisht është zgjidh kjo lëndë dhe operatori është duke e bë furnizimin por edhe ne kemi pas rezerva nëpër shkolla, përpos në shkollën në Samadraxhë, ku një ditë është ndërpre mësimi dhe është zëvendësu të shtunën. Asnjë orë mësimore nuk ka humbur për shkak të mungesës së lëndëve për ngrohje. Për pranimin, çdo shkollë e formon komisionin prej tre anëtarëve dhe drejtori i shkollës e përcjell .Dhe unë si menaxher i kontratës dal dhe te matjet ka procedura por është përgjegjëse drejtpërdrejtë shkolla ku i dorëzon mjetet dhe fatura kur të vje me një procesverbal që e bën komisioni i pranimit.

**Dardan Berisha** - si proces në korrik dhe gusht duhet me përfundu, Me sa e di unë, nuk është ashtu si thua ti sepse operatori po i bje të shtunën dhe të dielën, kur nuk është kërkush në shkollë. Në cilat shkolla ka pas lëndë djegëse rezervë?

**Remzi Bajselmani** - ka pas sepse deri në qershor ka pas sivjet dimër dhe shkollat janë furnizu prej operatorit paraprak. Tani janë zhvillu procedurat dhe është zgjidhë çështja afatgjate 3 vjeqare.

**Urim Suka** - Pyetje për Drejtorin e Arsimit: këtë drejtorin po e përcjellin dështimet dhe shkeljet ligjore në vazhdimësi. Së fundmi patëm probleme me lëndë djegëse nëpër shkolla. Kjo drejtorin edhe në kontrata tjera ka pas probleme për meremetimin e shkollave. Ka pas probleme të theksuara në vonesa, në planifikimin e implementimit të tyre. Në disa shkolla intervenimet janë bërë edhe pas fillimit të mësimimit duke e penguar edhe procesin mësimor. Drejtorin juaj ka lidh një kontratë për blerjen e mobiljeve dhe paisjeve për shkollat dhe qerdhet në vlerën prej 62.000€. Sipas informatave që kam, janë pajis disa shkolla me këtë kontratë. A mund të më tregoni se në cilat shkolla është intervenu me këtë kontratë dhe kërkoj që branda afateve ligjore të më sillni një kopje të faturave dhe raporteve të pranimit që janë bërë në emër të kësaj

kontrate.Pyetje për Drejtorinë e Bujqësisë:Këto ditë kam marrë shqetësime qytetare për problemet me qentë endacak.Gjatë shqyrtimit të kësaj çështje kuptova që ju prap keni dështuar së implementuari projektin e planifikuar për këtë çështje.Kur kësaj ia shton edhe dy dështime të dy viteve tjera paraprake pothuaj se në të njetat probleme rritet dyshimi që përveq paaftësisë së ekzekutimit të këtij projekti ka edhe interesa tjerë që ndikojnë në dështimin e tij.A ndjeheni përgjegjës për dështimin e tretë radhazi në tri vitet e fundit që keni planifiku mjete për trajtimin qenve endacak dhe nuk keni realizuar këtë projekt dhe çfarë do të ndodhë me mjetet që i keni planifiku ?Pyetje për Drejtorinë e Kulturës: siq e dime,fshati Mushtisht ka një shtëpi të kulturës dhe shumë fshatra nuk e kanë një të tillë mirëpo duke qenë në dijeni për traditën që ky fshat ka në kultivimin e vlerave tona kulturore,ne e mirëpresim një investim të tillë mirëpo meqenëse në këtë fshat ekziston një objekt shumë vjeqar me histori,dua të di nga ju se çka do të ndodhë me objektin e vjetër të shtëpisë së kulturës në këtë fshat?Gjithëashtu në këtë fshat është edhe objekti i vjetër i shkollës i cili sipas informatave që kam unë,është demoluar dhe është kthyer në një vend jo të këndshëm për nxënësit që frekuentojnë në këto hapsira.Çka do të ndodhë me objektin e shkollës së vjetër? Si Drejtori e Kulturës ju keni hap dy thirrje publike për subvencionimin e OJQ-ve.Kërkoj nga ju Drejtoreshë që përmes një raporti të na njoftoni me listen e OJQ-ve dhe personave që kanë apliku me emrin e projektit dhe shumën sa kanë apliku dhe sa kanë përfitu nga Komuna,dhe të thirrjes së parë dhe të thirrjes së dytë dhe listen e personave dhe OJQ-ve që janë refuzu dhe arsyet e refuzimit.

**Kryetari** - për pyetjet përgjigjen drejtorat.Unë dua të flas për shtëpinë e kulturës në Mushtisht.Ju e dini që edhe ma tutje ka kontest dhe aty ku ka kontest ju e dini që Kuvendi Komunal nuk kryen punë.Është një objekt që ka nevojë për investime shumë të mëdhaja.E ka marrë për sipër Ministria e Kulturës me një vendim të veçantë që don me bo meremetimin e asaj shtëpie.Poshtë nuk kemi mujt me ndërto shtëpinë e kulturës pasi që ka kontest mirëpo është një leje speciale që është lëshu nga instituti i ministrisë së kulturës dhe jemi duke vazhdu me punën por aty ka kontest.Te shkolla e vjetër e kemi një raport të cilin e kaluar nga policia e Komunës tonë e cila ka raportu që merret droga mirëpo deri sa ka hy në ligjin për mbrojtje,ne si Komunë nuk mund të pëzihemi dhe presim vendimin nga Instituti i Kulturës ose Ministria e Shëndetësisë.Sa i përket zyrës së prokurimit dua të jap sqarim.Procedurat kanë fillu në qershor dhe deri sa nuk kemi zotim nuk mund të fillojmë me procedura Kur është pjesa e madhe e një projekti,shkon me 45 ditë deri sa të vlerësohet.Lënda ka shku në OSHP dhe mua më vje mirë se si e ka vlerësu komisioni.E ka vlerësu edhe organi shqyrtues i prokurimit.

**Qëndrim Elshani** - në mungesë të drejtorit mund të përgjigjet edhe Kryetari sepse nuk është hera e parë që po e ngris si shqetësim punën e qasjes në rrugë kryesore nga rruga e stadiumit.Ne e dime që atë rrugë e shfrytëzojnë mbi 250 familje.Është duke u sanu shtegu i biqikletave dhe tash është rasti më i mirë që me sanu atë rrugë rrugë për një qasje më të lehtë të makinave. Është shqetësim edhe i qytetarëve që po vin ti shohin ndeshjet e futbollit të Bllkanit dhe të Suharekës.A ka me u lehtësu qasja në rrugën kryesore për makinat nga ajo rrugicë?

**Kryetari** - po flas së pari për rugën”Bali Kuçi”.Tri herë e kemi pas në buxhet dhe nuk kemi mujt me kry marrëveshjen për shkak të disa problemeve që janë pronësore juridike.Unë duhet me shku te prona dhe me bo kërkesën se si duhet me bo dhe çka në aspektin zyrtar dhe ligjor.Në qoftëse duhet me pas qasje pak më ndryshe atëherë duhet me thirr një ekspert të komunikacionit se si me bo atë punë.

**Urim Suka** - kur jemi te shtëpia e kulturës,mua më shqetëson fakti që një fshat e ka një shtëpi të kultuës dhe tash ti shkon investon dikun tjetër për shtëpinë e Kulturës.A ka leje ndërtimore ky objekt i ri që ke fillu me ndërto?Për deri sa ti ki shtëpi të kulturës dhe ka kontest,a je marrë ti me e zgjidh se çfarë kontesti paska kjo dhe çfarë plane don me pas?

**Kryetari** - kontesti nuk është sot.Kontesti është prej pas luftës dhe shumë prona të Komunës janë edhe ma tutje në kontest.Është duke u marrë avokati i Komunës me këtë punë.Nga Ministria e Kulturës është një leje e veçantë dhe ka leje edhe prej Komunës.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - në çfarë forme mundet me pas leje objekti nëse ka kontest prona?Në rastet kur ka prona kontest atëherë leja nuk guxon me u lëshu nga institucioni.

**Kryetari** - ku kemi lëshu leje nuk ka kontest.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - u shfaq kontesti më vonë sepse mu duk që tha.

**Kryesuesi** - është në vend tjetër duke u ndërto.

**Selman Kolgeci** - për hartën zonale ne e dim që në fund të vitit ka me pru një raport drejtori i urbanizimit për shkallën e realizimit të planit por paraprakisht na intereson me u informu se si është duke shku zbatimimi i tij.Më intereson të dijë procedurat e kushteve ndërtimore,respektivisht afatet kohore,a po respektohen në këto procedura?Kam ankesa prej shumë palëve që ka vonesa të mëdha në kthimin e përgjigjeve.Çka është problem këtu?A është plani i keq?A ka mungesë të stafit?A s'është trajnu stafi si duhet për zbatimin e planit të HZK apo ka probleme tjera? Ta dimë se ku është problemi.Familjarëve tuaj,njerëzve të pushtetit,lejet po ia bluni në dorë e operatorët tjerë po i zhagoni me kohë kogja gjatë.Me 3 korrik kanë fillu punën në rrugën Vraniq- Sopijë. Para dy seancave në këtë Kuvend i kam ngrit shqetësimet e mia dhe të shumë qytetarëve për zvarritje të punimeve në këtë rrugë dhe shumë rrugë tjera.Para këtij shqetësimi keni vazhduar të heshtni ndërsa qytetarët që frkuentojnë këtë rrugë në masë të madhe i kanë dëmtu mbështetëset e automjeteve të tyre.Ajo rrugë po bëhet nga taksat e qytetarëve dhe do të duhej ti shërbente qytetarëve sikurse do të duhej që ti gëzonte ky investim dhe jo ky investim të shëndrrohet në ankth për qytetarët tanë duke u frigu se sa kanë me zgjatë punimet në këtë rrugë.Kryetar,a dihet kur kanë me përfundu punimet në atë rrugë?Kam marrë disa ankesa nga shumë qytetarë të cilët iu kanë drejtuar drejtorit Kuçi për lejimin e vendosjes së ngadlësuesve të shpejtësisë(polic të shtrirë).Ata janë të ekspozuar ndaj një rreziku permanent e të përditshëm për aksidentet automjet-njeri.Në shumicën e përgjigjeve drejtori iu ka thënë se duhet me i pyet kryetarët e fshatrave.Këta as nuk e kanë zgjidh problemin por as nuk i kanë trajtu kërkesat e tyre.Kryetar,të lutem me i thënë drejtorit Kuçi që të trajtohen ato kërkesa dhe ti jepet zgjidhje qytetarëve.

**Kryetari** - është mirë këto pyetje me ia dërgu drejtorit me shkrim.Unë sipërfaqësisht do të mundohem.Nëse e ke për pengesën që po e kërkojnë qytetarët,kryetarët e fshatrave i ka zgjedh Asambleja komunale dhe nganjëherë është mirë me i pyet sepse ata tash në takimet që vin i kanë meditet e veta dhe është mirë me u këshillu me ta.Na kemi pas rast,e kemi vendos pengesën natën dhe kanë ardhë qytetarët,janë anku ditën dhe është dasht me hek.Këto bëhen në aspektin profesional dhe nuk mundem me vendos pengesa në çdo rrugicë të vogël mirëpo në aspektin profesional jep përgjigje drejtori.Te rruga ke plotësisht të drejtë për arsye se ligji i prokurimit ia mundëson ma të lirëve dhe ne në fillim e kemi ditë që ato rrugë me ato mjete është shumë problematike me u kry.Mirëpo është një kompani dhe është duke i kry punimet dhe në qoftëse deri më 15 nuk e përfundon,ne e shkëpusim kontratën.Mjete i kemi lëshu vetëm për ato punë që i ka kry.Lejet ndërtimore tash me kalimin e HZK-së dhe PZHK-së,asnjë milimetër nuk mund të kërkoj kërkuh por vetëm si është e paraparë me ligj.Kryetari tutje jep sqarime.

**Selman Kolgeci** - me sa po kuptoj unë,atyre që po i vonohen lejet është për shkak se janë duke kërku diçka jashtë hartës zonale,a po?

**Kryetari** - nuk jam unë ekspert,Ata duhet me zbatu planin që e kanë.Është ligjshmëria për sa e bën kërkesën dhe ku jepet përgjigja.

**Selman Kolgeci** - unë e kam shqetësimin veq pse po vonohet përgjigja.

**Kryetari** - a mund të pyes se për cilën lëndë.

**Selman Kolgeci** - kam shumë lëndë dhe nuk dua ti përmend me emra.P.sh. në Topliqan.

**Kryetari** - nuk jepen leje në Topliqan.

**Selman Kolgeci** - jepen leje.Kam në Suharekë ,te Gradinat.

**Kryetari** - te Gradinat pa e dhënë ministria nuk lëshojmë leje aty.

**Selman Kolgeci** - ti nuk iu ke përgjigj as në kërkesë.Kam edhe lëndë tjera që nuk iu ke përgjigj.

**Kryetari** - nuk është e vërtetë. Aty ka ardhë komisioni i Ministrisë së Kulturës,ka punu 30 ditë.

Të gjithë ata që i plotësojnë kushtet kanë me i marrë lejet.Të gjithë ata që nuk i plotësojnë kushtet s'ka leje.

**Selman Kolgeci** - ata i kanë plotësu lejet por ti nuk u je përgjigj.

**Kryetari** - nëse nuk u jemi përgjigj,janë organet përnjëherë,atje ku jeni msu me shku.Vazhdoni shkoni.Suhareka si Komuna e parë në Kosovë po e kryen vetingun.Të kanë dezinformu.

**Selman Kolgeci** - nuk më kanë dezinformu.I kam letrat përpara.

**Alban Berisha** - ti gjithë kohën na ke thënë: kqyr ku janë organet e drejtësisë.Ne se kemi pas plan dhe as nuk shkojna.

**Kryetari** - unë e kuptoj.Ne e kemi obligim me bashkëpunu me organet e drejtësisë,me iu përgjigj për çdo gjë.

**Alban Berisha** - në rregull.Ti e ke obligim me punu dhe ne e kemi obligim me të monitoru.Nëse unë e bëj një denoncim çoftë në polici,çoftë dikund,sot nuk jam spiun por sot jam bash patriot. Nuk kam fakte se me pas fakte unë shkoj.Kryetar,ti e din që të kam përkah për sheshin dhe kam marrë edhe kritika prej njerëzve të mi.Mirë që e ke bo sheshin sepse ka pas nevojë Suhareka por ti e din që unë kam pas edhe kritika,sidomos te trotuaret.Tash po punohet ka ish Benafi i vjetër dhe anën tjetër,aty trotuar nuk mundesh me i thënë.A ka mundësi seancën tjetër me sqaru se çka po ndodh në qytet.Shtegu i biçiklistave po bëhet por i ke ngushtu trotuaret, pikërisht te muzeu vetëm 1 m ka mbet trotuar.Te sheshi,ato rrethoja që janë bë për me i ruajt pemët,ato shtyllat e hekrit nuk po kuptoj se pse janë bë.

**Kryetari** - janë njerëz profesional të cilët i kanë bë.Është mirë me i pyet ekspertat sepse unë nuk e kam bë.Shpesh ndodh që këshillohem edhe me Selmanin në aspektin profesional.E kam thirr për rrethrotullimin në Sopijë dhe për Savrovë do ta thërras.Ne sheshin kemi me fillu prej urës së madhe dhe kemi me shku ka ura e vogël dhe shkojmë ngadal,ngadal.

**Alban Berisha** - ti sheshin je duke e bë edhe poshtë dhe nuk po e vlerësoj unë.Ishalla i ke zgjidh disa probleme me disa lokale që janë aty.Ti po thua eksperti.Experti i shtegut të biciklistave të tregon se si me bo shtegun.Kush është ai eksperti që ka thënë që duhet me u zvogëlu trotuari?Kur e ke nis në rrugën “Skënderbeu” kanalizimin,shumë mirë që e ke nis sepse ka pas nevojë por a duhet me u bë një plan operativ mos me u blloku ajo rrugë.Një ditë ka qenë kollaps qyteti prej veturave.Nuk guxon me u bë një punë kështu.Mendoj që e kemi përgjegjësi niveli komunal që me bo një orientim paraprak para se me ja nis një vend punishte.

**Kryetari** - vet jeni ju edhe unë që ai plan që e kemi ngrit dorën për atë plan dhe është monitoru dhe është pran nga Ministria e Planifikimit Hapsinor.Aty ka objete shumë katëshe.Ne e dime se çfarë kanalizimi ka dhe deri sa kemi pas problem me Dybyqakun dhe me sheshin,s’kemi problem më me ujë.Vendimet janë në komunë që janë shpronësu ato toka në vitin 1971.Janë të gjitha vendimet me emër dhe mbiemër.Pronën private nuk ia prekim askujt në atë rrugë.Në bazë të ligjit që është në fuqi ne kemi mendu edhe në bazë të ekspertave që nuk kemi nevojë me kërk pëlqim sepse është pjesë urbane rruga “Skënderbeu”.

**Urim Suka** - Kryetar përmende që jeni duke e kry vitingun.Komuna është duke iu nënshtru vitingut duke u thirrë në rezultatit me kritikën e vazhdueshme që i ka bë opozita.Me na pas ngu për ato kritika që i kemi bo ndoshta nëpër viting kishe kalu pak ma mirë.Komuna është duke iu nënshtru vitingut,ti po duket që nuk ke me kalu vitingun.

**Kryetari** - nuk po e di a je hetues apo çka je.Më vje mire që për rastin e fundit në Mushtisht dy gjëra i ka verifikiu prokuroria.Nuk dolën 72.000 as 74.000 dhe dolën metrat katrorë.Çdo pranim i punës që bëhet janë matjet gjeodezike që bëhen,që i bje kompania.Le të jep përgjegjësi çdo kush për veti.

**Selman Kolgeci** - u lidh me mu kur e pata fjalën dhe tha: shkoni atje ku jeni mësu me shku,Në prokurori shkoj dy deri tri herë në javë,qoj dhe marrë ekspertiza profesionale.

**Kryetari** - nuk të thash ty. Jam në shërbim të organeve pa asnjë problem.

**Alban Berisha** - asnjëherë kur ti ngritet një aktakuzë dikuj në ekzekutiv nuk jemi të lumtur ose nuk ndihemi të lumtur se nuk e ka qef dikush me u akuzu sepse tek e fundit janë të Komunës tonë.Ju jeni dëshmitar vet.Janë ngrit aktakuzat kundër zyrtarëve të ekzekutivit,asnjëherë nuk e kemi qel gojën për këtë temë.Unë si qytetar dhe si politikan ndihem i shqetësuar për secilën aktakuzë që mundet mu ngrit dhe uroj që secili prej juve,kushdo që është nën hetime me dal i pafajshëm.

**Kryetari** - kjo është demokraci.Këtu e kemi asambleistën Jehona dhe më duket dy vite e gjys ka pas kallzim penal dhe sot është këtu pa asnjë problem.Na iu besojmë organeve të drejtësisë dhe gjykatës.

**Remzi Bajselmani** - çështja e disa renovimeve ka qenë pak me vonesë por nuk e kanë pengu procesin mësimor.Me infrastrukturën shkollore qëndrojmë ma mire se çdo komunë tjetër në Kosovë.Çështja e tretë ishte një lëndë 62.000€.Se di sa ke informata,525 ditë ka zgjat deri sa është kry ajo lëndë nëpër organet e OSHP-së deri sa kanë vendos.U vendos që ta kryejnë Wud corporation.Janë faturat dhe procedurat që janë kry dhe kur të doni ju njoftojmë për këto.

**Ardian Kotorri** - është një temë që po stërzgjetet dhe është prej 2021-tës por unë mund të them me përgjegjësinë më të madhe publike edhe politike por edhe morale sepse edhe unë po kaloj nëpër qytet dhe po e shoh atë gjendje të qenve por megjithatë disa qenë duhet mi kqyr sepse ata janë në procedura të veterinarëve. Unë e kam inicuar këtë procedurë si kërkesë. Ka shkuar lënda te prokurimi, Prokurimi e ka vendosur si procedure. Kanë kërkuar sqarime kompanitë në mes vete konkurrencë në OSHP. OSHP-ja e ka kthyer që komuna ka të drejtë për kushtet që i ka vendosur. Në momentet e fundit asnjëra prej kompanive nuk konkuron. Unë e kam nisur një procedurë tjetër dhe besoj që kjo punë merr epilog. Drejtori tutje jep sqarime sa i përket qenve endacak.

**Lorika Gashi** - për shtëpi të kulturës, e shpjegoj Kryetari dhe qëndrojnë të njëjtat fjalë. Leje ka dhe parcela është afër shkollës kurse për raportin e dy thirrjeve publike, në momentin që kemi me pas gati, besoj që me email ke me pranuar.

**Urim Suka** - po pres prej dy drejtorive raportet që i kërkoja. Kam qef me bashkëpunuar. Ne jemi opozitë dhe kemi me kqyr ku po gaboni. Ju lutem mos gaboni. Ideja kur japim kritika nuk është personale por me mujt me bo diçka ma mire për njerzit. Në përgjigjen që i kthej Dardanit, Drejtoresha tha që kena marrë prej tepicës së fushës 7000€ një buxhet në Bllacë dhe Studenqan ndërkohë që fusha në Bllacë veq është bërë por as s'ka porta, as kosha, as s'ka rrethojë, është në gjendje katastrofë e paret paska pas me i quaj tjetërkund. Ai projekt s'ka pas parë të mjaftueshme për me u krye dhe prej aty i keni marrë dhe i keni quaj tjetërkund dhe fëmijët s'janë tu mujt me gëzu. Drejtori i bujqësisë, gjendja është alarmante. Unë e di për mundësitë që i ka Komuna, e di ligji pak a shumë se si funksionon. Komuna e ka një mundësi dhe atë mundësi që tri vjet pe planifikon dhe ajo mundësi që tri vjet po i dështon. Duhet me kqyr çka po ndodh. Duhet me marrë pak ma seriozisht. Nëse s'mundesh me bo zgjidhje, pse po i planifikon dhe nuk po e realizon?

**Kryesuesi** - puna e qenve endacak është problem nacional.

**Ardian Kotorri** - kur kam ardhë në 2022-tën e kam gjetur një lëndë në OSHP të inicuar të 2021-tës. Në momentin që e ka trajtuar lëndën, e ka dhënë të drejtën prokurimit të Komunës së Suharekës. Ne kemi vazhdu me procedurat tona dhe lëndën prapë e kanë dërguar në OSHP kompanitë që po konkurojnë këtë drejtim. Prapë e kemi inicuar një procedurë të re. Lënda ka shkuar në OSHP dhe prapë i ka dhënë të drejtë Komunës. Ka qenë afati për me konkuru dikush por s'ka konkuru askush. Çka me bo Drejtoria e Bujqësisë në këtë drejtim?

**Visar Kuçi** - fusha në Studenqan e ka pasur një projekt dhe ka qenë buxheti i zotun për atë pjesë të fushës kurse fusha në Bllacë këtë vit ka pasur mu punuar faza e parë, por nuk do të thotë që është keqmenaxhu sepse janë kanë të planifikuar 80.000€ dhe operatori ekonomik ka hy me çmim diku me 61.000€. Pjesa e mbetur e mjeteve që është ofertuar në Bllacë dhe Studenqan është bartur në projektin e viti të kaluar. Drejtori tutje jep sqarime sa i përket fushës së Gjinocit.

**Urim Suka** - paret që kanë mbetur, ke mujt menjëherë me bo procedurën tjetër dhe me u krye ajo fushë. Nuk e keni bo dhe pe qoni dikun tjetër. Në planifikimin që e keni për buxhetin për këto dy fusha shkruan: Ndërtimi i fushave sportive Studenqan dhe Bllacë. Nuk e ndan me faza planifikimi i buxhetit që e kemi miratuar.

**Visar Kuçi** - gabim e ke qasjen, si ndaj qytetarit, si ndaj postimit, si ndaj drejtorave. Me 19.000 € të tjera nuk përfundon faza e dytë. Ta kam shpjeguar edhe në teren. E ke të ndaluar me hy në punishte ti edhe çdo kush pa autorizim.

**Urim Suka** - me sa zell po m'fol drejtori për të drejtat dhe përgjegjësitë që unë kam për me hy në punishte. Do të isha shumë i kënaqur që drejtori dhe secili drejtor tjetër dhe secili person përgjegjës, para meje me i pa ato punishte dhe mos me i lënë në atë gjendje ku mun me u rreziku jeta e njerëzve.

**Shefket Kolgeci** - shkolla e Vraniqit për ujë të pijës është në mënyrën ma të keqe të mundshme. Është një ujësjellës, ujë ka por nuk ka menaxhim. Unë kam kërkuar para dy-tre mbledhjeve që me nda mjete për me i siguruar ujë shkollës. Të lutem drejtor me na informuar se a ka në atë drejtim diçka. Tash po ndërtohet shkolla e re dhe po më duket e kanë lënë anash por fëmijët mund të infektohen atje.

**Remzi Bajselmani** - shqetësimi është shumë me vend. Unë e njoh situatën dhe jam kujdes për personalisht për këtë çështje. E kemi hap ofertën, kemi nda mjete por nuk ka pas ofertues serioz.

Tani është në proces ku do të mbyllet kjo çështje dhe do të rregullohet puna e ujësjellësit.

**Selman Kolgeci** - po,e kemi diskutu këtë temë dhe unë ia kam bërë projektin pa pagesë ashtu qysh e kam premtuar dhe e pash që paska dalë në prokurim për ri tender.Shqetësimi im ka qenë edhe te nyjet sanitare.Drejtor,sinqerisht kërkoj me marrë masa për me i rregullu nyjet sanitare për shkak të rrezikut të përhapjes së ndonjë sëmundje aty.Në afërsi të shkollës”Destan Bajraktari” po krijohen kolona për shkak se prindërit me automjetet e tyre po shkojnë ti marrin fëmijët e tyre në shkollë.Në mënyrë që qytetarët të mos ballafaqohen me këto kolona,kërkoj që të trajtohet parkingu i shkollës dhe të krijohet një qasje tjetër në rrugë e cila në masë të madhe do ta lironte komunikacionin.E kam pa që ka mundësi.Është shqetësuese se si fëmijët e klasave 1 deri 4 por edhe të tjerët gjatë kohës së pushimit të gjatë,lejohen të dalin në markete në rrugë.Ju lutem merrni masa para se ndonjëri prej nxënësve me pësu.Pyetje Drejtorit të Bujqësisë: Ju lutem a mund të na informoni më shumë rreth kontrollit të paisjeve dhe mekanizmave bujqësor.Është fakt i ditur që po sa të shpërndahen mekanizmat bujqësor në Suharekë,shumë nga përfituesit që zakonisht dalin bashkëpartiakët tuaj,i qesin paisjet në shitje në web faqe në Kosovë.A ka komision që ka me i kontrollu këto paisje dhe që i ka kontrollu dhe sa është koha që ata oblingohen me i mbajtë dhe me punu me to? Pyetje për Drejtorinë e Kulturës:Me 6 shtator ka fillu festivali i teatrove në Suharekë.A është mbështet ky projekt?Nëse po,sa është mbështet financiarisht? Është e pa precedentë që deri më tani që të bojkotohet një festival i tillë me të cilin duhet të krenoheshim të gjithë.E kuptoj që mund të keni mospajtime dhe hatërmbetje me ndonjërin nga organizatorët por ju përfaqësoni institucion edhe shqetësohem se si institucioni që do të promovonte dhe do të përkrahte ngjarje të tilla,ka zgjedhur bojkotin ndaj tyre.

**Remzi Bajselmani** - u diskutu çështja e ujit dhe ajo ndërlihet me punën e tualeteve.E kemi transferu një punëtor tekniq atje,pikërisht për kushte higjienike me u kujdes pak më tepër por mbi të gjitha edhe objekti është shumë i vjetër dhe jemi të shqetësuar shumë për Vraniqin.Jemi tu e prit edhe ministrinë për shkollën e re dhe besoj që do ti zgjidh të gjitha problemet.

Edhe ne jemi të informuar për te Destan Bajraktari.I kam bërë thirrje dy shkollave që bordi i shkollës të bëjë zgjidhje për një byfe brenda.Ndërsa për pjesën tjetër e kemi diskutu me Drejtorin e Urbanizmit,që punët e parkingut do të rriten edhe te 7 Marsi edhe te Destan Bajraktari.

**Doruntina Zenelaj** - pse janë ndal punimet në Vraniq?A e dini arsyen?

**Remzi Bajselmani** - për shkak të ngecjes që ka bërë operatori,ju ka ndërpre kontrata dhe ka me u zhvillu procedure e re.

**Ardian Kotorri** - forma e përzgjedhjes bëhet kështu:aplikojnë fermerët e Komunës së Suharekë.Një komision bëhet prej Drejtorit të bujqësisë dhe unë të grantoj me përgjegjësi të madhe që nuk bëjmë dallime politike.Urim Suka ka qenë në atë periudhë kur dalin rezultatet.

Drejtori tutje jep sqarime dhe thotë që sa i përket shitjeve është e mundshme por me gjithëatë kur do që e vërejmë ne,kemi me marrë masa në këtë drejtim.

**Selman Kolgeci** - ata pse po i shesin?A jeni duke i kontrollu?A ka komision që shkon mbas një viti dhe i kqyr se a është duke i përdor?Ju po thoni që s’po din me i plotësu letrat.A ka këshilltar?

Kryetari i ka pagu 12.000€ për këshilltar.Pse se merrni një këshilltar?

**Ardian Kotorri** - për dallim prej zyreve tjera që aplikacionet i bëjnë në zyrën nr.1,ne për këtë punë aplikacionet i pranojmë në zyrën e Drejtorisë së Bujqësisë.

**Lorika Gashi** - festivali i teatrove u përkrah por të them të drejtën nuk e di në çfarë shume u përkrah sepse u përkrah në afatin e pare të subvencioneve.Hatërmbetje s’ka me kërkan.Kush do që e ka dëmtu institucionin ose ka linqime në emrin tim personal,ka me u përball me drejtësinë sepse është e drejta ime.Nuk e kemi bojkotu si Komunë.Ka pas drejtor pjesmarrës në aktivitetet e festivalit të teatrove.Te subvencionet shumica e keqkuptojnë pjesën e shumës.Subvencioni nuk është me kry projektin por është një shtytje e projektit.Sa do që e ka pa komisioni të arsyeshme, është edhe vlerësimi me pikë.

**Selman Kolgeci** - mua më intereson se a është përkrah dhe sa.Unë i kam pa dy drejtorë që kanë qenë aty por nuk kanë qenë të subjektit tuaj,kanë qenë të PDK-së.M’ka shqetësu fakti që qysh drejtoresha e kulturës nuk është prezente në javën e festivalit të teatrove dhe as Kryetari.

**Lorika Gashi** - nuk është e nevojshme me u shqetësu sepse është një komision monitories.Nuk e ka obligim ligjor drejtoresha e kulturës në secilin aktivitet të cilin e subvencionon me qenë pjesë.

I obligim është komisioni monitories me marrë pjesë.Se sa është përkrah,ta dërgoj me email.



**Jehona Rrafshi** - Drejtoria e Arsimit ka bërë një kontratë për shujtën e nxënësve të ciklit të ulët të shkollave fillore.Kjo kontratë ka qenë valide deri me 10 dhjetor.Pse kjo kontratë është ndërpre paraprakisht dhe a do të ketë vazhdim të kësaj kontrate?Gjithëashtu konkursi për dhënien e bursave për nxënës dhe studentë veq është hapur.Disa herë e kemi cekur çështjen e rregullores e cila ka disa vështirësi që ne hasim,Pse ka mungu vullneti me përmirësu këtë rregullore duke e pas parasysh që edhe ne e kemi qenë të interesun që të bashkëpunojmë në këtë rregullore.Po ndërlihem te Albani.Po më vje mire që ka njerëz si ti që ndien keqardhje te një aktakuze të një zyrtari publik por dua ta kesh parasysh që ka njerëz shumë të këqinjë të cilët po punojnë në këtë drejtim,për ngritjen e një aktakuze.Le të jetë në ndërgjegjen e x personave.

**Remzi Bajselmani** - deri më tani ka ndodh furnizimi.Ka pas mjaft vështirësi dhe pakënaqësi në këtë aspekt.Kemi disa shkolla që kanë kërku të ndërpritet furnizimi sepse kiflet nuk kanë qenë cilësore dhe vështirësia e pagesave që është në këtë periudhë,kemi marrë vendim të ndërpritet furnizimi i kifleve dhe nuk kemi më buxhet dhe ministria nuk e ka parapa që të vazhdoj ky proces.Sa i përket rregullores,unë disa here kam kërku që të përmirësohet rregullorja.Kemi insistu dhe e kemi sjell në Asamble dhe është votu por nuk ka pas vullnet për ndryshim të rregullores.Kam prit nga komisioni që jeni ju,që do ta iniconi si procedurë.

**Jehona Rrafshi** - ne komisioni nuk mujna me marrë rregulloren vet me punu për deri sa nuk kemi një urdhër ekzekutiv nga ana juaj si drejtor.

**Remzi Bajselmani** - komisioni që është votu dhe është me mandate 4 vjeqar dhe ky komision është kompetentë për këtë proces.Unë kam prit që në shtator do të ketë ndërhyrje por nuk ka pas vullnet për ndryshimin e rregullores dhe është kjo aktualja.

Takimi përfundoi: 13:25

Procesmbajtësja:  
Dafina Haziraj